



MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZË STATISTIKORE
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore

SHTATOR 2023

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

© *Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë*

Tabela e përmbajtjes

H Y R J E.....	4
KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore.....	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse, të autorizuara	15
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	22
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010	24
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë).....	26
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)	27
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese).....	28
KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE.....	30
Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.	30
Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.....	30
Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.....	32
Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.	32
Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.....	33
Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.	34
KONKLUSIONE.....	35
Sa i përket ndihmës juridike parësore.....	35
Sa i përket ndihmës juridike dytësore.....	35
Numri i vendimeve gjyqesore të ankimuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.....	36
Ankimet e pranuar nga gjykatat e apelit (civil, administrativ) sipas juridiksionit	36
Kërkesat për ndihmë juridike dytësore të rrëzuara apo të pushuara nga gjykata	36
Kërkesa për ndreqje gabimi të depozituara në gjykatë.....	36
Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata.....	36

Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të pranuar për ekzekutim pagese	36
Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të refuzuara për ekzekutim pagese	36
Informacion mbi pagesat e përfaqësimit të avokatëve të ndihmës juridike dytësore si dhe shpenzimet gjyqësore të likujduara.....	37
NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- DHJETOR 2023.....	38
NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR-DHJETOR 2023.....	39
Të dhënat statistikore për vitin 2023 (<i>Sipas gjinisë, natyrës së çështjes dhe kategorisë përfituese të përcaktuar në ligj</i>).....	40

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike, ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e *cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.*

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mblidhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjukata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës detyësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndhimja juridike parësore jepet nga: *Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuar dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Shtator 2023, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron 20 (njëzet) Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore si vijon:

- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Lushnjë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Tropojë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Përmet** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Pukë** ((me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Mat** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Kavajë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Kurbin** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Gjirokastrë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Fier** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Elbasan** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).

- ❖ **Berat** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Kukës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).
- ❖ **Korçë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);


Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Kategori e veçante
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative	Romë&Egjiptian)	(Viktima Dhune)
Tiranë	31	-	31	13	18	31	-	26	5 (aftësi e kufizuar)	-	22	4	5	1	-
Durrës	25	-	25	15	10	25	-	19	6 (1 viktimë dhune, 5 aftësi e kufizuar)	-	11	5	9	-	1
Lushnjë	20	-	20	15	5	20	-	17	3 (1 viktimë dhune, 1 aftësi e kufizuar, 1 ndihmë ekonomike)	-	18	1	1	4	1
Shkodër	27	-	27	13	14	27	-	18	9 (5 viktimë dhune, 3 kncap, 1 ndihmë ekonomike)	-	21	1	5	-	5
Tropojë	15	-	15	7	8	15	-	2	13 (7 skema e mbrojtjes sociale, 5 aftësi e kufizuar, 1 viktimë dhune)	-	2	-	13	-	1
Përmet	3	-	3	-	3	3	-	-	3 (pensionist)	-	1	-	2	-	-
Pukë	2	-	2	1	1	2	-	-	2 (1 kncap, 1 pensionist)	-	-	-	2	-	-
Mat	6	-	6	3	3	6	-	6	-	-	-	-	6	2	-
Kavajë	17	-	17	7	10	17	-	17	-	-	7	1	9	-	-
Kurbîn	6	-	6	2	4	6	-	2	-	4	4	1	1	-	-
Lezhë	30	-	30	14	16	30	-	26	4 (aftësi e kufizuar)	-	17	-	13	-	-
Gjirokastrë	39	-	39	18	21	39	-	16	23 (7 skema e mbrojtjes sociale, 3 aftësi e kufizuar, 2 ndihmë ekonomike, 11 pensionist)	-	5	1	33	6	-
Pogradec ¹	3	-	3	3	-	3	-	1	2 (1 kncap, 1 aftësi e kufizuar)	-	2	-	1	-	-
Fier	18	-	18	9	9	18	-	13	5 (2 viktimë dhune, 3 aftësi e kufizuar)	-	3	-	15	-	2
Dibër	10	-	10	3	7	10	-	7	1 (viktimë dhune)	2	4	3	3	1	1

¹ Janë raste të trajtuara nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec gjatë muajit Shtator, por për shkak të tranerimit të zyrës, për arsye logjistike janë raportuar në muajin Shtator.


Vlorë	24	-	24	12	12	24	-	20	4 (1 skema e mbrojtjes sociale, 3 aftësi e kufizuar)	-	2	-	22	2	-
Elbasan	17	-	17	12	5	17	-	5	12 (9 skema e mbrojtjes sociale, 3 aftësi e kufizuar)	-	13	2	2	-	-
Berat	29	-	29	22	7	29	-	27	2 kmcap	-	7	-	22	1	-
Kukës	16	-	16	6	10	16	-	2	14 (13 skema e mbrojtjes sociale, 1 aftësi e kufizuar)	-	1	-	15	-	-
Korçë	46	-	46	28	18	46	-	15	31 (skema e mbrojtjes sociale)	-	3	-	43	-	-
TOTALI	384		384	203	181	384		239	139	6	143	19	222	17	11

Për muajin Shtator 2023 janë administruar 384 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore


Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore




Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore sipas natyrës së çështjes




Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



**Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive
përfituese të përcaktuara në ligj**



TË DHËNA SPECIFIKE MBI KATEGORITË E VEÇANTA PËRFITUESE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



Kategoria e veçantë	Nr. i përfituesve në total nga QSHNJP-të 2023												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Viktima të dhunës në familje	13	16	10	10	16	14	15	10	11				115
Viktima të abuzuar seksualisht													
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore													
Viktima të mitur		1					1	1					3
Të mitur në konflikt me ligjin													
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore													
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar	31	34	28	36	44	31	51	32	41				328
Statusi i të verbrit			2		1	2	1	1					7
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor													
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor													
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar		2				1							3
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	41	39	61	35	56	67	40	66	68				473
Përfitues të ndihmës ekonomike	5	4	3	4	7	6	8	6	4				47
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim						1							1
Pensionistë		2			5	3	7	7	15				39
Nr. Total i përfituesve sipas kategorisë së veçantë - 2023	90	98	104	85	129	125	123	123	139				1016
Nr. Total i përfituesve Romë/egjiptiane - 2023	38	27	32	21	22	18	22	16	17				213

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura e dhënies të autorizimeve për periudhën 2022-2024, ka përfunduar më datë 27.09.2022, përmes lëshimit të Urdhrave të Ministrisë të Drejtësisë për **15 (pesëmbëdhjetë) Organizata Jofitimprurëse**, si vijon:

- *Forumi i Gruas Elbasan (FGE)*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Shpresa Banja.
- *Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)*, Dr. Ekzekutiv: Z.Altin Hazizaj
- *Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Aurela Bozo.
- *Qendra Psiko-Sociale Vatra*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Brikena Puka
- *Qendra e Gruas Hapa të Lehtë*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Denada Shpuza.
- *Qendra ALTRI*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Eda Noçka.
- *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Iris Luarasi
- *Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Artë Dyrmishi
- *Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Mariana Hereni
- *Organizata “Refleksione”*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Anthulla Ruçi.
- *Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin*, Dr. Ekzekutiv: Zj. Elona Hoxha.
- *Qendra “Konsumatori Shqiptar”*, Dr. Ekzekutiv: Zj.Ersida Teliti.
- *Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara*, Dr. Ekzekutiv: Zj. Anjeza Puka.
- *Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”*, Dr. Ekzekutiv: Zj. Marjana Meshi.
- *Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”*, Dr. Ekzekutiv: Zj. Rajmonda Bozo.


OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes				Përkatësi a Etnike Romë & Egjiptianë
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërckt.	Civile	Penale	Administrative	Përcckt.	
1. “Qendra e Këshillimit për Grat dhe Vajza”	97	3	94	93	4	96	1	-	33	64 (63 dhunë në familje, 1 Aft.kuf.)	-	78	11	8	-	-
2. “Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	5	-	5	1	4	5	-	-	-	3 (papërcck. Katg.)	2	-	-	5	-	-
3. “Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara” QSHPLI	20	-	20	11	9	20	-	-	20	-	-	9	-	11	-	-
4. “Qendra Vatra”	25	-	25	22	3	25	-	-	3	22 (dhunë në familje)	-	25	-	-	-	-
5. “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” (CRCA)	3	-	3	-	3	3	-	-	-	-	3	3	-	-	-	-
6. “Forumi i Gruas Elbasan”	8	-	8	8	-	8	-	-	8	-	-	8	-	-	-	1 (Egjpt)
7. “Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	38	22	16	20	18	30	1	7	38	-	-	-	-	38	-	-
8. “Të ndryshëm dhe të barabartë”	23	3	20	22	1	23	-	-	1	22(12 dhunë në familje, 1 vikt.abuzuar sek, 9 viktima trafikimi)	-	10	3	10	-	-

9. "Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)	5	-	5	4	1	5	-	-	5	-	-	-	-	5	-	-
10. "Qendra për nisma ligjore qytetare" QNL	25	1	24	25	-	25	-	-	11	14 (11 dhunë në familje, 1 I mitur, 2 pensionistë)	-	24	1	0	-	2(Egjpt)
11. "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët" RMSA	13	-	13	6	7	-	13	-	-	-	13	-	-	13	-	-
12. "Qendra Konsumatori Shqiptar"	6	-	6	2	4	6	-	-	-	1 (1 pensionistë)	5	-	-	6	-	2 (Rom)
13. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)	25	-	25	17	8	25	-	-	16	9 (papërck. Katg.)	-	-	-	25	-	10 (Rom)
14. Qendra e Gruas "Hapa të lehtë"	27	-	27	26	1	27	-	-	1	26 (papërck. Katg.)	-	-	-	-	27	1 (Egjpt)
15. Organizata "Refleksione"	12	7	5	10	-	10	-	-	-	-	12	-	-	-	12	-
TOTAL²	334	36	296	267	63	308	15	7	136	161	35	157	15	121	39	16


Për muajin Shtator 2023 janë administruar 334 raste nga OJF-të e autorizuara

² 4 Egjiptianë dhe 12 Rom kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin Shtator 2023; 36 të mitur kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin Shtator 2023;


Rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara




Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes




Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



TË DHËNA SPECIFIKE MBI KATEGORITË E VEÇANTA PËRFITUESE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



Kategoria e veçantë	Nr. i përfituesve në total nga OJF-të - 2023												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Viktima të dhunës në familje	61	67	44	98	92	83(1 mitur)	81 (2mit)	60	108				694
Viktima të abuzuar seksualisht	2		1	3	1				1				8
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	5	5	5	14	10	9 (3 mitur)	7	11	9				75
Viktima të mitur	2		4	2		Total 4 ³			1				9
Të mitur në konflikt me ligjin													
Fëmijët, të cilët jetojnë në inst. e përkujdesjes shoq.													
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin/kundër kujdestarit të tyre													
Personat që përfitojnë nga PAK/ KMCAP	3	7	4	3	4	9	4	3	1				38
Statusi i të verbrit													
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në inst. e shërbimit të shëndetit mend.													
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor													
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja/kufizimi i zotësisë për të vepruar													
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale		1		10		11	1						23
Përfitues të ndihmës ekonomike													
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim													
Pensionistë	8	5	2	1	4	5		1	3				29
Kategori e veçantë, por e papërcaktuar në raportim					11	11	12		38				72
Nr. Total i përfituesve sipas kategorisë së veçantë - 2023	81	85	60	131	122	128	105	75	161				948
Nr. Total i përfituesve Romë/egjiptiane	10	2	3	7	21	13	25	3	16				100

³ Viktimat e mitur në total 4, nuk janë përlogaritur te numri total si kategori e veçantë, pasi janë përlogaritur 1 rast viktimë dhune dhe 3 viktima te mundshme trafikimi.

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me **12 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë**, konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. Kolegji Universitar “Wisdom”;
3. Klinika e Ligjit Shkodër;
4. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;
5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;
6. “Universiteti Europian i Tiranës”;
7. “Universiteti “Qirjazi”
8. Universiteti “Bedër”
9. Universiteti “Mesdhetar”
10. Universiteti “Marin Barleti”
11. Universiteti “Luarasi”
12. Universiteti “Epoka”.

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgjojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutuar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues. Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin Shtator 2023 janë administruar 2 raste nga Klinika e Ligjit ‘Bedër’, pranë IAL-ve.

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010

Platforma Juristionline

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar **për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh, të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrajnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojmë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

RASTET E TRAJTUARA Shtator 2023 (54)

19 Civile; 32 Administrative; 3 Penale


Numri i Gjellbër 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarrja për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion **një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike**. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. *Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.*

NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)

TOTALI I RASTEVE (Telefonatave) 11

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga Çdo Ofrues i Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore




Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Shtator 2023

718 raste⁴

⁴ Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Shtator 2023, duke përfshirë **Platformën Juristi Online**, si dhe **Nr. e Gjellbër është 783.**


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)



Nr. Përfituesve sipas gjinisë	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Klinika e Ligjit	Nr. Total⁵
Femra	203	267	-	470
Meshkuj	181	63	-	244

⁵ Nr. Total i përfituesve, të ndarë sipas gjinisë nuk përfshin rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër.


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)



Nr. Përfitues sipas natyrës së çështjes	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Nr. Klinkat e Ligjit	Nr.Total⁶
Civile	143	157	-	300
Penale	19	15	-	34
Administrative	222	121	2	345
E papercaktuar	-	39	-	39

⁶ Nr. Total i përfituesve, të ndarë sipas natyrës së çështjes nuk përfshin rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online dhe Nr.i Gjellbër.

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese)



Përfituesit sipas kategorisë përfituese		QSHNJP	OJF	Total
1	Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	239	136	375
2	Kategoritë e veçanta kryesore përfituese	139	161	300
	Viktima të dhunës në familje	11	108	119
	Viktima të abuzuar seksualisht		1	1
	Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore		9	9
	Viktima të mitur		1	1
	Të mitur në konflikt me ligjin			
	Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoq.			
	Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa/kundër miratimin e kujdestarit të tyre ligjor			
	Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar	41	1	42
	Statusi i të verbrit			
	Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor			
	Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor			
	Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar			
	Personat të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike	4		4
	Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	68		68
	Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor			
	Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi/mosveprimi që përbën diskriminim			
	Pensionistë	15	3	18
	Kategori e veçantë, por e papërcaktuar kategoria		38	38
3	Të paidentifikuar	6	35	41

KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

Të dhëna statistikore: Sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, rezulton se për **49 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, **29** prej tyre rezultojnë për kërkuese gra, dhe **19** prej tyre për kërkues burra. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra Shtator 2023		
<i>Kategoria Gra / Burra</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkues Gra	29	<i>Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Shtator 2023 janë më shumë gra se kërkuesit burra.</i>
Kërkues Burra	19	
Papërcaktuar	1	
TOTALI = 49 Vendime Gjyqësore		

Të dhëna statistikore: Sipas kategorive përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, rezulton se nga **49 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **21** prej tyre rezultojnë për kërkues që pretendojnë se i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme, **28** prej tyre rezultojnë nga kërkues që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas kategorive përfituese SHTATOR 2023

<i>Kategoria përfituese</i>		<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
1	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	21	<p>1. Për muajin Shtator 2023 vihet re që qytetarët që kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore i përkasin kategorive të veçanta.</p> <p>2. Evindetohet një rritje e numrit të kërkuesve për ndihmë juridike në krahasim me muajin e kaluar.</p>
2	<i>Viktima të dhunës në familje</i>	7	
	<i>Viktima të abuzuar seksualisht</i>		
	<i>Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore</i>		
	<i>Të mitur</i>		
	<i>Viktima të mitur</i>		
	<i>Të mitur në konflikt me ligjin</i>		
	<i>Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore</i>		
	<i>Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor</i>		
	<i>Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar</i>	10	
	<i>Statusi i të verbrit</i>	6	
	<i>Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor</i>		
	<i>Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor</i>		
	<i>Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar</i>		
	<i>Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale</i>	5	
	<i>Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor</i>		
<i>Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim</i>			
<i>Romë/egjiptiane</i>			
<i>Pensionistë</i>			
3	E pa specifikuar në vendimin gjyqësor	0	
TOTALI = 49 Vendime Gjyqësore			

Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, rezulton se nga **49 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **7** prej tyre janë kërkesa për dhënie të ndihmës juridike dytësore me avokat, **29** prej tyre janë kërkesa për dhënie të ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **13** kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi llojin e ndihmës dytësore të kërkuar			
Shtator 2023			
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar		Numri i Përfituesve	Komente / të tjera
1	Ndihmë juridike dytësore me avokat	7	<i>Në analizë të përgjithshme, shihet që në pjesën më të madhe, kërkuarit kërkojnë ndihmën juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.</i>
2	Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	13	
3	Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	29	
TOTALI = 49 Vendime Gjyqësore			

Të dhëna statistikore: Sipas vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, nga **49 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, rezulton se janë pranuar **47** kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, dhe 2 vendime të rrëzuara. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore vendimmarrjes së gjykatave ose organit procedues				
SHTATOR 2023				
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar	Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim / rrëzim/ pranim pjesërisht	Numri i Kërkuarve		Komente / të tjera
1	Pranuar	6	7	<i>1. Për muajin Shtator kemi 1 vendim për ndihmë juridike që është rrëzuar për shkak se është jashtë juridiksioni, si dhe një vendim të rrëzuar nga gjykata.</i>
	Rrëzuar	-		
	Pushuar Çështja	-		
	Prishje vendimi/ Kthim Rigjykim	-		
	Kthim aktesh	-		

		Shpallje moskompetence	1	
2	Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	12	13
		Rrëzuar	1	
		Pushuar Çështja	-	
		Prishje vendimi/ Kthim Rigjykim	-	
		Kthim aktesh	-	
		Shpallje moskompetence	-	
3	Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	29	29
		Rrëzuar	-	
		Pushuar Çështja	-	
		Prishje vendimi/ Kthim Rigjykim	-	
		Kthim aktesh	-	
		Shpallje moskompetence	-	
TOTALI = 49 Vendime Gjyqësore				

Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, rezulton se nga **49 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, **30** prej tyre janë çështje civile, **15** janë çështje administrative, si dhe **4** çështje penale.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas natyrës së çështjes gjyqësore që kërkohet ndihma SHTATOR 2023			
Lloji i çështjes		Numri i kërkuessve	Komente / të tjera
1	Civile <i>(pronësie, pjestim pasurie, vjetërsi pune)</i>	30	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet që në ndihma juridike kërkohet për çështje civile në pjesën më tërë të rasteve. 2. Gjatë muajit Shtator evidentohet një rritje e vendimeve për ndihmë juridike dytësore për çështjet Administrative.
2	Penale	4	
3	Administrative	15	
4	N/A	-	
TOTALI = 49 Vendime Gjyqësore			

Të dhëna statistikore: Sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Shtator 2023, rezulton se nga **49 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **shumica i përkasin Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm** dhe një pjesë e vendimeve është dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë.

Vendimet e depozituara në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas nga Gjykatat, janë pasqyruar në tabelën si vijon:

Të dhëna statistikore sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin Shtator 2023			
<i>Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore</i>	<i>Komente / të tjera</i>	
Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm	Tiranë	2	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, numri i vendimeve i përket, në pjesën më dërmuese, gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm krahasimisht me gjykatat administrative. 2. Të gjitha vendimet gjyqësore për kërkesat mbi ndihmën juridike janë përcjellë nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë dhe Rrethe.
	Durrës	4	
	Elbasan	1	
	Fier	7	
	Gjirokastrë	1	
	Lezhë	3	
	Lushnjë	-	
	Berat	2	
	Dibër	1	
	Vlorë	2	
	Shkodër	3	
	Kukës	1	
Tropojë	-		
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Durrës		
	Tiranë	5	
	Lushnjë	8	
	Gjirokastrë	2	

KONKLUZIONE

✚ Sa i përket Ndhmës Juridike Parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin **Shtator 2023**, në total rezultojnë **718 raste**, nga të cilat **384 raste janë trajtuar nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore**; **332 raste janë trajtuar nga Organizatat Jofitimprurëse** të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. Nuk është raportuar asnjë rast i trajtuar nga Klinikat e ligjit, që funksionojnë pranë IAL-ve;
- ✓ Në lidhje me rastet e trajtuara nga Platforma Juristionline.al dhe Nr.i Gjellbër 08001010, janë administruar përkatësisht **54 raste nga Platforma Juristionline.al dhe 11 raste nga Nr.i Gjellbër 08001010**.
- ✓ Sa i përket Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore **qendrat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara janë: Qendra Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë**. Qendrat që kanë nevojë për **promovim të shtuar janë Qendra Përmet, Pukë, Pogradec dhe Mat**.
- ✓ Sa i përket Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar, organizatat me numrin më të lartë të rasteve janë: **Organizata ‘Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, ‘Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)’ dhe Qendra e Gruas Hapa të lehtë**;
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se pjesa më e madhe e rasteve të trajtuara janë **të natyrës administrative (48%), pasuar nga çështjet civile (42%) dhe çështjet penale (5%)**. Numri më i madh i përfituesve sipas **gjinisë rezultojnë të jenë femra (72%), pasuar nga meshkujt (28%)**.
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve, ku përfitues janë kategoritë në **pamundësi financiare (52%)** si dhe **kategoritë e veçanta përfituese (42%)**, kurse 6% mbeten të papërcaktuara nga ofruesit e shërbimit.

✚ Sa i përket Ndhmës Juridike Dytësore

- ✓ Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin **Shtator 2023**, në total rezultojnë **49 vendime** gjyqësore, nga të cilat janë pranuar 47 kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe 2 vendime të rrëzuara.
- ✓ Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile (*pronësi, zgjidhje martesë, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*)
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, rezulton se:**

- Numri i vendimeve gjyqësore të ankimuar nga DNJF për muajin Shtator 2023: **1 Vendim**
- Numri i ankimeve të pranuar nga Gjykata e Apelit për muajin Shtator 2023: **0 Vendime**
- Numri i ankimeve të rrëzuara nga Gjykata e Apelit për muajin Shtator 2023: **0 Vendime**
- Kërkesë për ndreqje gabimi të depozituar në gjykatë për muajin Shtator 2023: **0 Kërkesë.**
- Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata për muajin Shtator 2023: **1 Kërkesë.**
- Kërkesa për ndreqje gabimi rrëzuar nga gjykata për muajin Shtator 2023: **0 kërkesë.**
- Numri i dosjeve avokatë/ekspertë të dorëzuara për ekzekutim pagese në Sektorin e Financës dhe Buxhetit për muajin Shtator 2023: **15 dosje.**
- Numri i dosjeve avokatë/ekspertë të refuzuara për ekzekutim pagese për muajin Shtator 2023: **4 Dosje**

INFORMACION MBI PAGESAT E PËRFAQËSIMIT TË AVOKATËVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE SI DHE SHPENZIMET GJYQËSORE TË LIKUJDUARA

- Në total gjatë muajit **Shtator 2023** janë likuaduar **40 vendime** gjyqësore me vlerë totale prej **1,371,250 lekë**
- Në total për periudhën **Janar – Shtator 2023** janë likuaduar **268 vendime** gjyqësore me vlerë totale prej **9,522,350 lekë**.

VLERË				SASI		
	Avokatë	Ekspertë	Gjykata	Avokatë	Ekspertë	Gjykata
Janar	110,500	80,000	0	4	2	0
Shkurt	369,500	240,000	0	12	6	0
Mars	805,000	280,000	0	23	7	0
Prill	732,500	575,000	0	22	15	0
Maj	1,523,000	720,000	13,000	42	18	2
Qershor	541,000	150,000	0	17	4	0
Korrik	725,000	555,000	0	21	15	0
Gusht	310,000	333,000	0	8	9	0
Shtator	1,051,250	320,000	88,600	32	8	0
Tetor						
Nëntor						
Dhjetor						
TOTAL	6,167,750	3,253,000	101,600	181	84	3

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- DHJETOR 2023

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatat jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Total
Janar	305	235	0	540
Shkurt	295	251	0	546
Mars	324	177	14	515
Prill	283	265	1	549
Maj	321	212	3	536
Qershor	326	223	0	549
Korrik	312	234	0	546
Gusht	296	166	0	462
Shtator	384	332	2	718
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				
Total	2846	2095	20	4961

Total Ndhimja Juridike Parësore Janar – Shtator 2023: 4961 raste të raportuara⁷

⁷ Rastet e trajtuara në total, së bashku me Platformën Juristi Online dhe Nr. i Gjellbër, për periudhën Janar – Shtator 2023 është 5744.

Rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online për periudhën Janar – Shtator 2023 është 650.

Rastet e trajtuara nga Numri i Gjellbër për periudhën Janar – Shtator 2023 është 133.

NDIHMJA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- DHJETOR 2023

Vendime Gjyqësore me Objekt Kërkesë për Ndihmë Juridike Dytësore

JANAR – SHTATOR 2023

Muaji	Kërkesa për ndihmë Juridike Dytësore						Përfundim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore						Kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përfundim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore						Vendime Total	
	Pranim	Rrëzim	Pushim	Kthim aktesh	cështje në gjykim	Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim	cështje në gjykim	Kthim aktesh	Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim	cështje në gjykim	Kthim aktesh	Mos-kompetencë		Prishje vendimi/kthim për rigjykim
Janar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	57	6	1	-	-	-	-	64
Shkurt	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	67	3	-	-	-	-	-	70
Mars	1	-	-	-	-	-	6	-	-	-	-	-	40	2	1	-	1	1	1	53
Prill	3	-	-	-	-	-	3	-	2	-	-	-	65	-	-	-	1	-	-	74
Maj	23	-	-	-	-	-	5	-	-	-	-	-	53	5	-	-	-	-	-	86
Qershor	24	-	-	-	-	-	11	-	-	-	-	-	24	4	-	-	-	-	-	63
Korrik	23	2	-	1	-	-	8	1	-	-	-	-	35	-	-	-	-	-	-	70
Gusht	3	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	13	-	-	-	-	-	-	17
Shtator	6	-	-	-	-	1	12	1	-	-	-	-	29	-	-	-	-	-	-	49
Tetor																				
Nëntor																				
Dhjetor																				
Total	83	2	-	1	-	1	46	2	2	-	-	-	383	20	2	-	2	1	1	546
	87						50						409							

Totali i Vendimeve Gjyqësore për Kërkesat për Ndihmë Juridike Dytësore

Janar – Shtator 2023 është 546

TË DHËNAT STATISTIKORE

JANAR – SHTATOR 2023

Të dhëna statistikore mbi numrin e total të qytetarëve që kanë përfituar Ndhimë Juridike Parësore/ Dytësore, për periudhën **Janar – Shtator 2023**:

- Sipas Gjinisë⁸

Lloji i ndihmës	Meshkuj	Femra	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Ndhimë Juridike Parësore</i>	1846	3138	4984
<i>Ndhimë Juridike Dytësore</i>	202	343	545

- Sipas Natyrës së Çështjes⁹

Lloji i ndihmës	Civile	Penale	Administrative	Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Ndhimë Juridike Parësore</i>	1999	277	2505	63	4844
<i>Ndhimë Juridike Dytësore</i>	462	32	50	4	546

- Sipas Kategorive Përfituese të Përcaktuara në Ligj¹⁰

Lloji i ndihmës	Kategoritë pa të ardhura dhe pasuri	Kategoritë e vecanta	E papërcaktuar	Nr. Total i rasteve për të gjithë qytetarët përfitues - 2023
<i>Ndhimë Juridike Parësore</i>	2292	1710	285	5003
<i>Ndhimë Juridike Dytësore</i>	280	265	1	546

⁸ Nr total i qytetarëve që kanë përfituar Ndhimë Juridike Parësore/ Dytësore nuk përfshin nr. e përfituesve të administruar nga **Platforma Juristi Online dhe Nr. i Gjellbër 08001010**.

⁹ Nr total i qytetarëve që kanë përfituar Ndhimë Juridike Parësore/ Dytësore nuk përfshin nr. e përfituesve të administruar nga **Platforma Juristi Online dhe Nr. i Gjellbër 08001010**.

¹⁰ Nr total i qytetarëve që kanë përfituar Ndhimë Juridike Parësore/ Dytësore nuk përfshin nr. e përfituesve të administruar nga **Platforma Juristi Online dhe Nr. i Gjellbër 08001010**.

Kategoria e veçantë	Ndihmë Juridike Parësore	Ndihmë Juridike Dytësore	Kategoria Total
Viktima të dhunës në familje	809	81	890
Viktima të abuzuar seksualisht	8		8
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	76	1	77
Viktima të mitur	11		11
Të mitur në konflikt me ligjin			
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore		2	2
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor		1	1
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	366	64	430
Statusi i të verbrit	7	15	22
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor			
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor			
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar	3		3
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	496	77	573
Përfitues të ndihmës ekonomike	47		47
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor			
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim	1		1
Pensionistë	68	15	83
E papërcaktuar kategoria e veçantë përfituese	72		72
Nr. Total i kategorive të veçanta - Ndihmë Juridike Parësore/ Dytësore - 2023	1964	256	2220
Romë/egjiptiane	313	-	313
Të mitur total ¹¹	303	-	303

¹¹ Të mitur total nuk përlogaritet nr i viktimave të mitur, apo të mitur në konflikt me ligjin, si kategori e veçantë.